




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.276/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Vedat Poterqoi – Kryetar, znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani – Referuese, znj. Nita Bejta - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “U-Unique”SH.P.K.– Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE: “EnGroup”SH.P.K.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i shkollave paralele të ndara : Jeta e Re, Konjuh, Vershec, Resinovec, Llugë, Gadime e Ulët, Vrellë e Goleshit, Krojmir, Mirenë, Zllakuqan- Faza e II-të”, me nr. të prok: 613-22-3801-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Lipjan”, më datën: 08.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “U-Unique”SH.P.K.– Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i shkollave paralele të ndara : Jeta e Re, Konjuh, Vershec, Resinovec, Llugë, Gadime e Ulët, Vrellë e Goleshit, Krojmir, Mirenë, Zllakuqan- Faza e II-të”, me nr. të prok: 613-22-3801-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Lipjan”.

II.VËRTETOHET, njoftimit i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i shkollave paralele të ndara : Jeta e Re, Konjuh, Vershec, Resinovec, Llugë, Gadime e Ulët, Vrellë e Goleshit, Krojmir, Mirenë, Zllakuqan- Faza e II-të”, me nr. të prok: 613-22-3801-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Lipjan”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “U-Unique”SH.P.K.– Prishtinë, i refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “U-Unique”SH.P.K.– Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 17.07.2022 me nr. 276/22, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi i shkollave paralele të ndara : Jeta e Re, Konjuh , Vershec , Resinove , Llugë , Gadime e Ulët , Vrellë e Goleshit , Krojmir , Mirenë , Zllakuqan-Faza e II-të”, me nr. të prok: 613-22-3801-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna Lipjan”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 parag. 2 , 7 parag. 1 , 2, 4 , 59 parag 2 dhe 4 , 60 parag 1 , si dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, Si dhe nenin 4.4 , 40 , dhe 42 pika 3 e RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.07.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 28.07.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “U-Unique”SH.P.K.–
Prishtinë,

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, ka pranuar nga AK-ja, letrën standarde si tenderues i pasuksesshëm, ndërsa ne ankesën e tij te parashtruar ne OSHP, ka pretendime lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontratë. OE ankues, pretendon se, OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar inxhinierin e Arkitekturës z. Blerim BAJRAKTARAJ, ku i ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara, por nënshkrimi i paraqitur ne CV dhe ne kontrate nuk korrespondon me njeri tjetrin, gjë që na shtynë në dyshime për një manipulim të mundshëm.

- Lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues, fillimisht sqaron se AK-ja, edhe ne përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim ka deklaruar se nuk jemi kompetent për verifikim dhe hulumtim te nënshkrimeve dhe se mund ti drejtoheni organeve tjera kompetente. Eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron arsyetimi i AK-se i dhënë lidhur nënshkrimet e inxhinierit te arkitekturës te cilët janë te ndryshëm ne CV dhe ne kontratën e punës. Konform nenit 72 dhe 59 te LPP-se, AK-ja është dashur te kërkojë sqarim me shkrim nga inxhinieri i lartpërmendur i cili ne CV-in e tij e ka dhënë e-mail adresën dhe numrin kontraktues, për faktin se nënshkrimet e inxhinierit ne fjalë ne CV dhe ne kontrate janë te ndryshme. Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë çështje, me date: 28.07.2022, i është drejtuar me shkrim inxhinierit te Arkitekturës – Blerim Bajraktaraj, nga i cili është kërkuar qe te sqarohet lidhur me nënshkrimet e vendosura ne CV dhe ne kontrate te punës. I njëjti me datën: 28.07.2022, ne përgjigje ka deklaruar se: “Po, te dy nënshkrimet janë te Mijat, dhe i tere dokumentacioni i përgatitur është ne koordinim me Mua...!”. Prandaj pretendimi i OE ankues për manipulim te nënshkrimit nuk qëndron.

OE ankues, pretendon se, OE i rekomanduar për kontrate, ka prezantuar në ofertë si teknikë të elektros z. Afrim BAJRAMI i cili sipas diplomës së ofruar nuk është teknikë i elektros por elektroteknike e automatikës, andaj nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së.

-Lidhur me kete pretendim eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues lidhur me diplomën e teknikut te elektros, sepse ne diplome është shënuar se Afrim Bajrami është i diplomuar ne degën e elektroteknikes drejtimi teknik i automatikes. Sa i përket pretendimit te OE ankues, se OE nuk ka bashkangjitur CV për asnjërin nga teknikët e prezantuar, andaj sipas OE ankues, nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së te vendosur ne dosje te tenderit.

-Lidhur me pretendimin e cituar me larte, eksperti shqyrtues sqaron se nuk qëndron ky pretendim, për faktin se gjate vlerësimit te ofertave, AK-ja konform nenit 72 te LPP-se, ka kërkuar sqarime shtese lidhur me CV-it e teknikeve, i cili ne përgjigje te kërkesës se AK-se, ka dhënë te gjitha sqarimet e nevojshme, prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se i rekomanduari për kontrate e ka plotësuar kërkesën e dosjes se tenderit. OE ankues pretendon se, Lista e pajisjeve teknike c. Makine për suvatim min. 2 copa, Dëshmia e kërkuar: Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE, për automjetet qe nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes. Për automjetet qe regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve, OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim dhe dëshmitë tjera përkatëse. O.E. me rastin e dorëzimit të dosjes së tenderit nuk ka dorëzuar fare marrëveshje për shfrytëzimin e makinave te suvatimit me kompaninë VALI COM, e vetmja dëshmi qe OE fitues i posedon këto pajisje ka qene lista e pajisjeve e dorëzuar nga OE ku faturat e blerjes kane munguar, por pas kërkesës për rishqyrtim nga ana jone ne përgjigjen e AK-s e: Komuna e Lipjanit është bashkangjitur marrëveshja për shfrytëzimin e makinave te suvatimit me kompaninë Vali Com e jo dëshmi te blerjes për pajisjet e paraqitura ne liste.

-Sa i përket këtij pretendimi eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky pretendim, për faktin se OE i rekomanduar për kontrate i ka paraqitur 2 makina për suvatim si te huazuara, dhe mbi bazën e nenit 72 te LPP-se, AK-ja, ka kërkuar sqarime dhe ne përgjigje OE i rekomanduar për kontrate i ka ofruar AK-se te gjitha dëshmitë e nevojshme lidhur me pronësinë dhe dëshmia ne fjale është konform nenit 72.3 te LPP-se. Prandaj nuk qëndron pretendimi se për shkelje te nenit 59.2 te LPP-se, për ndryshim materiale te ofertës, sepse OE i rekomanduar për kontrate e ka prezantuar ne listën e pajisjeve si te huazuara. Eksperti shqyrtues, vlerëson se AK-Komuna Lipjanit, i ka zbatuar procedurat e nenit 59 dhe 72 te LPP-se dhe me këtë rast ka respektuar nenin 1 dhe 6 te LPP-se dhe njeherit eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore te parashtruara nga OE ankues janë te pa bazuara.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, ndërsa vendimi i AK-së, për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 28.07.2022, me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 01.08.2022, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: “U-Unique”SH.P.K.– Prishtinë, me datë: 09.08.2022, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.09.2022, pa praninë e palëve në procedurë konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbal i mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur për të gjitha pretendimet ankimore të OE ankues se autoriteti kontraktues Komuna Lipjan, ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me njoftimin për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit, paneli shqyrtues i klasifikon si të pabazuara dhe mbështetet në raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues të caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tij profesional është që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues. Kështu që, edhe arsyetimet e dhëna nga eksperti shqyrtues llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Vedat POTERQOI



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “KK- Lipjan”,

1x1 OE - “U-Unique”SH.P.K.– Prishtinë”,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.